



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 167

Tiranë – E premte, 6 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 4.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në lidhje me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 52/2018.....
	13013
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 687, datë 15.11.2019	Për delegim kompetence.....
	13020
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 179, datë 20.11.2019	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).....
	13020
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 180, datë 20.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.....
	13021
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 181, datë 20.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar.....
	13023
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 182, datë 20.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar.....
	13024
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 183, datë 20.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.....
	13026

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 184, datë 20.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike.....	13028
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 185, datë 20.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kritereve për të vendosur kufizime, sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit”	13030
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Edmond Kananaj.....	13031



VENDIM

Nr. 772, datë 4.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 1, TË
MARRËVESHJES SË GRANTIT,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “HEKURUDHAT
SHQIPTARE – REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS
DHE NDËRTIMI I LINJËS
HEKURUDHORE PËR NË
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË
TIRANËS”, NË LIDHJE ME NJË GRANT
INVESTIMI NGA FONDI I
PËRBASHKËT EVROPIAN I
BALLKANIT PERËNDIMOR,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 52/2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në lidhje me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 52/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE NDRYSHUESE NR. 1

E MARRËVESHJES SË GRANTIT, TË
DATËS 9 MAJ 2018, NË LIDHJE ME NJË
GRANT INVESTIMI NGA FONDI I
PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT
PERËNDIMOR PËR PROJEKTIN
“HEKURUDHAT SHQIPTARE –
REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE
TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMI I
LINJËS HEKURUDHORE PËR NË
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË
TIRANËS”
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
DATË 9.9.2019

Kjo marrëveshje ndryshimi, e datës 9.9.2019, (“**Marrëveshje Ndryshimi**”) është lidhur nga dhe ndërmjet:

1. **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“**Marrësi**”); dhe
2. **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**, një organizatë ndërkombëtare e formuar mbi bazë traktati (“**BERZH**”),

duke pasur parasysh se:

A. Marrësi ka lidhur një marrëveshje granti, e datës 9 maj 2018 (“**Marrëveshja Fillestare**”) me BERZH-in, sipas të cilit BERZH-i ka rënë dakord t’i japë Marrësit një grant sipas kushteve të Marrëveshjes Fillestare; dhe

B. Me kërkesën e BERZH-it, bazuar në nevojën për të përfshirë në marrëveshjen e lartpërmendur të grantit, dispozita shtesë për administrimin e fondeve të granteve të parashikuara për dy bashkëpunimet teknike (TC) lidhur me projektin, për: i) mbështetje për zbatimin e Projektit; dhe ii) shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve, Marrësi dhe BERZH-i dëshirojnë të ndryshojnë Marrëveshjen Fillestare në disa aspekte, në dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Ndryshimi.

Si rrjedhojë, aktualisht, palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1

Përkufizime dhe interpretime

- a) Në këtë Marrëveshje Ndryshimi:



“Data e hyrjes në fuqi” nënkupton datën në të cilën BERZH-i do të marrë një njoftim nga Marrësi për përfundimin e procedurave të saj të brendshme ligjore në lidhje me këtë Marrëveshje Ndryshimi.

“Marrëveshja Fillestare” ka kuptimin e dhënë në pikën A.

b) Termat e përcaktuar në Marrëveshjen Fillestare (qoftë drejtpërdrejt ose duke iu referuar ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti tjetër), nëse nuk përcaktohen ndryshe këtu, kanë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje Ndryshimi. Dispozitat e seksionit 1.02 të Marrëveshjes Fillestare do të kenë efekt si të përcaktuara në këtë Marrëveshje Ndryshimi në mënyrë të plotë, *mutatis mutandis*.

c) Marrëveshja Fillestare dhe kjo Marrëveshje Ndryshimi duhet të lexohen dhe të interpretohen si një dokument i vetëm.

Seksioni 2

Ndryshimi dhe vazhdimësia

a) Me efekt në dhe nga data e hyrjes në fuqi, Marrëveshja Fillestare do të amendohet me ndryshimet e përcaktuara më poshtë në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje Ndryshimi.

b) Dispozitat e Marrëveshjes Fillestare, me përjashtim kur ndryshohen me këtë Marrëveshje Ndryshimi, vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 3

Përfaqësimet dhe garancitë

a) Marrësi përfaqëson dhe garanton BERZH-in si më poshtë:

1. Ka të gjithë kompetencën dhe autoritetin e duhur për të zbatuar, dorëzuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Ndryshimi dhe Marrëveshjes Fillestare të ndryshuar dhe të riparaqitur në pajtim me këtë Marrëveshje Ndryshimi.

2. Ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar zbatimin, shpërndarjen dhe përmbushjen e saj nga kjo Marrëveshje Ndryshimi dhe Marrëveshja Fillestare e ndryshuar dhe e riparaqitur në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshimi.

3. Kjo Marrëveshje Ndryshimi është zbatuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ajo dhe kjo Marrëveshje Ndryshimi dhe Marrëveshja Fillestare e ndryshuar dhe e riparaqitur në pajtim me këtë

Marrëveshje Ndryshimi, përbëjnë detyrimet e saj të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme, të zbatueshme kundrejt saj në përputhje me kushtet e tyre përkatëse.

4. Të gjitha pëlqimet, autorizimet dhe veprimet e çdo lloji të nevojshëm për ekzekutimin, dorëzimin dhe performancën e vlefshme nga kjo Marrëveshje Ndryshimi dhe për ecurinë e vlefshme të Marrëveshjes Fillestare të ndryshuar dhe të riparaqitur në pajtim me këtë Marrëveshje Ndryshimi, janë marrë dhe janë në fuqi të plotë.

b) Secili nga përfaqësimet dhe garancitë e përfshira në seksionin 3.01 të Marrëveshjes Fillestare do të konsiderohet të përsëritet nga Marrësi në datën e hyrjes në fuqi, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese në datën në vijim, sikur të përcaktohet në tërësi, *mutatis mutandis*.

c) Marrësi pranon se ka bërë përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme, me synimin e nxitjes së BERZH-it për të lidhur këtë Marrëveshje Ndryshimi dhe se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje Ndryshimi në bazë të dhe në mbështetje të plotë të secilës prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive. Marrësi garanton se nuk ka njohuri për ndonjë fakt apo çështje shtesë, mungesa e së cilës bën që ndonjë nga këto përfaqësime dhe garanci të jenë të paqarta.

Seksioni 4

Garanci të mëtjeshme

Marrësi, me kërkesë të BERZH-it dhe me shpenzimet e veta, kryen të gjitha aktet dhe veprimet e nevojshme ose të dëshirueshme për të zbatuar ndryshimet e bëra ose që do të zbatohen në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshimi.

Seksioni 5

Të ndryshme

a) Të gjitha referencat ndaj “Marrëveshjes” në Marrëveshjen Fillestare dhe të gjitha referencat ndaj Marrëveshjes Fillestare në këtë Marrëveshje Ndryshimi dhe të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e tjera të zbatuara në bazë të saj, i referohen Marrëveshjes Fillestare, të ndryshuar dhe të riparaqitur në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshimi.

b) Kjo Marrëveshje Ndryshimi mund të ndryshohet vetëm me një dokument me shkrim të



nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit dhe nga një zyrtar i autorizuar i BERZH-it.

c) Kjo Marrëveshje Ndryshimi mund të zbatohet/nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku përbëjnë një marrëveshje të vetme.

d) Dispozitat e seksioneve 8.03, 10.01, 10.04, 10.07, 10.08 dhe 10.10, të Marrëveshjes Fillestare të ndryshuar në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshimi, përfshihen me anë të referencës dhe përbejnë pjesë të kësaj Marrëveshjeje Ndryshimi, siç përcaktohet plotësisht këtu, *mutatis mutandis* dhe (pa cenuar përgjithësinë e saj) sikur referenca në këtë Marrëveshje “Marrëveshja” të ishte ndaj kësaj Marrëveshjeje Ndryshimi.

e) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si heqje dorë nga BERZH-i për cilindo privilegj, imunitet dhe përjashtim që i janë dhënë BERZH-it sipas Marrëveshjes që përcakton BERZH-i, konventës ndërkombëtare ose çdo ligji të zbatueshëm.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje Ndryshimi të zbatohet dhe të dorëzohet në datën e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Anila Denaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: Susan Goeransson

Titulli: Drejtor, Kryesues për Infrastrukturën në Evropë

SKEDULI 1 NDRYSHIMI I MARRËVESHJES FILLESTARE

Marrëveshja Fillestare ndryshohet si më poshtë:

1. Në faqen 1 të Marrëveshjes Fillestare teksti i mëposhtëm do të vendoset më poshtë “(Numri i operimit 48466)”:

“Marrëveshja për Grant Bashkëpunimi Teknik nr.: C40458/6871/28931

Marrëveshja për Grant Bashkëpunimi Teknik nr.: C41050/6871/38277”.

2. Në faqen 1 të Marrëveshjes Fillestare, teksti i mëposhtëm do të fshihet në tërësi “(Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës)” dhe zëvendësohet me formulimin e mëposhtëm:

“(Hekurudhat shqiptare: i) Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës; ii) Mbështetje për zbatimin e projektit; dhe iii) Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve)”.

3. Pika “G” e preambulës fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me formulimin vijues:

“G) Më 16 dhjetor 2016, Komiteti Drejtues i Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (“WBIF”) ka rënë dakord, në përputhje me kushtet dhe rregullat e Rregullores së Fondit, të japë një grant (“Granti”) në një shumë që nuk tejkalon 32,935,000 euro (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë euro) nga burimet e fondit, duke iu nënshtruar afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje për të bashkëfinancuar deri 50 për qind të kostove kapitale të Projektit në përputhje me metodologjinë e tyre të re për mbështetjen e investimeve në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Të ardhurat nga ky Grant do të vihen në dispozicion të subjektit të Projektit me anë të një marrëveshjeje transferimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Marrësit dhe subjektit të Projektit (“Marrëveshje Transferimi”).”.

4. Një pikë e re “H” do të vendoset në fund të preambulës:

“H) Në pajtim me Marrëveshjen e Fondit të Bashkëpunimit Teknik ndërmjet Fondit dhe Bankës, Fondi ka miratuar dhe ka rënë dakord të sigurojë fonde në dispozicion deri në 2,500,000.00 euro (dy milionë e pesëqind mijë euro) në bazë të grantit (“Granti i TC-së”) për të financuar shërbimet e konsulencës për mbështetjen për zbatimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve të çdo konsulenti që do të prokurohen në përputhje me Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe procedurat e tjera të Bankës në afatet dhe në kushtet e përcaktuara më poshtë. Të ardhurat nga ky grant TC duhet të vihen në dispozicion të subjektit të Projektit nëpërmjet Marrëveshjes së Transferimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe



Ekonomisë së Marrësit dhe subjektit të Projektit, siç është përcaktuar më sipër.”

5. Përkufizimet e reja në vijim përfshihen në seksionin 1.01 (*Përkufizimet*):

“Zërat Capex (Shpenzimeve të kapitalit) të financuar nga Granti” nënkupton punimet për Projektin që do të financohen nga financimi i Grantit, siç përshkruhet më tej në pjesën A, të skedulit 2 (*Zërat Capex të financuar nga Granti*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Granti i TC-së” ka kuptimin që i është dhënë në pikën “H”.

“Zërat e TC-së të financuar nga Granti” nënkupton shërbimet e nevojshme për projektin që do të financohen nga financimi i Grantit, siç përshkruhet më tej në pjesën B, të skedulit 2 (zërat e TC-së të financuar nga Granti) në këtë Marrëveshjeje.

“Financimi i TC-së nga granti” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.01 (a).”

6. Përkufizimi i “Kontratave” dhe “Zërat e financuar nga Granti” fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

““Kontratat” nënkupton kontratat e vendosura ose të lidhura ndërmjet subjektit të Projektit dhe çdo kontraktuesi, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin, duke përfshirë edhe zërat e financuar nga Granti, dhe që do të financohen në tërësi ose pjesërisht me financimin e Grantit”.

“Zërat e financuar nga Granti” nënkupton zërat Capex të financuar nga Granti dhe zërat e TC-së të financuar nga Granti.”

7. Seksioni 2.01 (*Shuma, monedha dhe qëllimi*), paragrafët “a” dhe “b” fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

a) sipas dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, Banka bie dakord që t’i japë Marrësit nga Fondi:

i. një grant në shumën jo më të lartë se 32,935,000 euro (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë euro) (“Financimi me Grant”); dhe

ii. një grant në vlerë që nuk tejkalon 2,500,000 euro (dy milionë e pesëqind mijë euro) (“Financimi i TC nga Granti”);

b) financimi me grant do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të zërave të financueshëm nga Granti të përcaktuara në skedulin II, të cilat duhet

të prokurohen sipas seksionit 4.06 (*Prokurimi*) të kësaj Marrëveshjeje.

8. Seksioni 2.01 (*Shuma, monedha dhe qëllimi*), paragrafi “e” fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin vijues:

“e) Përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

1) Zëra të financuar nga Granti bashkëfinancohen nga financimi me grant dhe financimi me Hua në raporte dhe në shuma që duhet të përcaktohen në Planin e Prokurimit;

2) Shuma e financimit të Grantit e alokuar për çdo zë të financuar nga Granti sipas Planit të Prokurimit:

a) në asnjë moment nuk kalon 50 për qind të vlerës së kontratës në lidhje me zërin e financuar nga Granti lidhur me kontratën e punimeve sipas pjesës A, numër 1, të skedulit 2; dhe

b) mbulon plotësisht vlerën e kontratës për zërat e financuar nga Granti sipas pjesës B, numër 1 (shërbime të mbikëqyrjes së punimeve) dhe numrin 2 (mbështetje zbatimi), të skedulit 1 dhe asnjë pjesë e të ardhurave të financimit me grant nuk përdoret, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të paguar blerjen e tokës ose ndërtesave, në territorin e Marrësit ose diku tjetër.

9. Seksioni 2.02 (*Disbursime*), paragrafi “c” fshihen tërësisht dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

“Pa kufizuar përgjithësimin e këtij seksioni 2.02, çdo disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një ose më shumë zëra të financuar nga Granti të renditura në pjesën A, të skedulit II (*Zërat e financuar nga Granti*) i nënshtrohet përmbushjes ose heqjes dorë në diskrecion të vetëm të Bankës, tërësisht ose pjesërisht dhe sipas kushteve ose moskushtëzimit të kushtit që në datën e kërkesës së Marrësit për këtë disbursim:

1) Banka ka pranuar një kërkesë të kënaqshme tërheqjeje në përputhje me Marrëveshjen e Huas në lidhje me financimin e Huas së alokuar për të njëjtët zëra të financuar nga Granti (për një shumë të paktën të barabartë me 50 (pesëdhjetë) për qind të totalit të shpenzimeve të financohen nga ky disbursim dhe tërheqja e njëkohshme në mënyrë kolektive; ose

2) Shuma e financimit të Huas të tërhequr ose të kërkuar, sipas një kërkesë të pranueshme tërheqjeje nga Marrësi në cilësinë e Huamarrësit, është të paktën e barabartë me atë të financimit të Grantit të disbursuar ose të kërkuar sipas një kërkesë të



pranueshme disbursimi nga Marrësi në përputhje me Marrëveshjen e Huas”.

10. Një seksion i ri 2.07 (*Pagesat për financimin e Grantit të TC-së*) shtohet në fund të nenit II:

“Seksioni 2.07

Pagesat e financimit të Grantit të TC-së

a) Pas marrjes së një fature dhe dokumenteve mbështetëse nga kontraktuesit, të dorëzuara në përputhje me dispozitat e kontratave, Marrësi do të sigurojë që subjekti i Projektit të kontrollojë, sa më shpejt që është e arsyeshme, dhe të verifikojë faturën dhe përmbushjen e pranueshme të këtyre shërbimeve të Kontraktuesit, të cilit i referohet fatura.

b) Nëse këto shërbime janë të pranueshme dhe subjekti i Projektit bindet se shumatat e ngarkuara në faturë korrespondojnë me shumatat e përcaktuara në kontratën përkatëse të konsulencës, Marrësi do të sigurojë që subjekti i Projektit të dërgojë faturën, dokumentet mbështetëse dhe një deklaratë (siç është paraqitur në figurën 3 të kësaj Marrëveshjeje) që vërteton miratimin e shërbimeve, më pas duhet të përcillet tek operacionet e financuara nga Donatori i Bankës në Londër ose përmes e-mail-it në DonorInvoices@ebrd.com”.

11. Seksioni 4.02 (*Përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e Projektit*), paragrafi “a”, nënparagrafi 4, fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

“4) mundëson që data e realizimit të Projektit të jetë jo më vonë se data 31 dhjetor 2020 dhe

12. Seksioni 4.06 (*Prokurimi*), paragrafi “a”, fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin në vijim:

“a) Prokurimi i të gjithë zërave të financuar nga Granti, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, rregullohet nga rregullorja e BERZH-it për prokurimet. Zërat e financuar nga Granti prokurohen me tender të hapur, siç përcaktohet në kapitullin 3 të rregullores së BERZH-it për prokurimin. Zërat e financuar nga Granti i TC-së do të sigurohen nëpërmjet tenderimit të hapur, siç përcaktohet në seksionin III, neni 5, i rregullave të prokurimit të BERZH-it.”.

13. Seksioni 4.08 (*Kontratat*) fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me formulimin e mëposhtëm:

“a) Marrësi do të sigurojë që subjekti i Projektit t’i japë Bankës kopje të noterizuara të të gjitha

origjinaleve të ekzekutuara të kontratave jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e tyre.

b) Marrësi garanton që subjekti i Projektit të sigurojë që të gjitha kontratat të përfshijnë dispozita bindëse për Bankën, të cilat kërkojnë që një kontraktues dhe nënkontraktuesit e tyre: i) të mospërfshihen në ndonjë praktikë të ndaluar; dhe ii) të njoftojnë menjëherë subjektin e Projektit nëse çmohet se janë ose janë bërë një subjekt i përjashtuar.

c) Banka, pas shpalljes së kontratës fituese, mund të publikojë një përshtypje të saj, emrin dhe shtetësinë e Kontraktuesit dhe çmimin e kontratës.

d) Marrësi garanton që subjekti i Projektit menjëherë njofton Bankën për pezullimin ose ndërprerjen e kontratave, ose për çdo rast që mund të çojë në pezullimin ose ndërprerjen e kontratave.”.

14. Seksioni 4.09 (Evidenca dhe raporte të projektit; ekzaminime), paragrafi “e”, fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

“Marrësi garanton që subjekti i Projektit të sigurohet që Bankës dhe përfaqësuesve të tij t’u ofrohen qasje në librat e llogarisë së subjektit të Projektit dhe të dhënat lidhur me Projektin, këtë Marrëveshje, kontratat, financimin e Grantit të TC-së dhe financimin e Grantit.”.

15. Seksioni 6.01 (*Pezullimi*), në fund të këtij seksioni përfshihen paragrafët e rinj 17 dhe 18:

17) Çdo kontratë është pezulluar ose përfunduar në përputhje me kushtet e saj dhe asnjë kontratë zëvendësimi me të njëjtin ose një Kontraktues tjetër nuk është lidhur brenda 120 ditëve të punës nga data e pezullimit ose e anulimit; ose

18) Subjekti i projektit nuk ka paguar elementin e taksave të tërthorta (duke përfshirë çdo TVSH) mbi faturat e kontraktuesit në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e kontratave.”.

16. Seksioni 6.02 (*Anulimi nga Banka*), paragrafi “d”, fshihen tërësisht dhe zëvendësohen me formulimin vijues:

“d) Nëse Banka, në çdo moment, konstaton që:

1) prokurimi i ndonjë prej artikujve të financuar me grante nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje;

2) çdo kontratë ka skaduar ose është ndërprerë në përputhje me kushtet e saj dhe asnjë kontratë zëvendësuese me të njëjtin ose një kontraktues



tjetër nuk është lidhur brenda 120 ditëve të punës nga data e pezullimit apo anulimit;

3) fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

4) në lidhje me ndonjë kontratë, çdo përfaqësues i Marrësit, subjektit të Projektit ose ndonjë kontraktues ka marrë përsipër ndonjë praktikë të ndaluar gjatë prokurimit ose zbatimit të kësaj Kontrate, pa Marrësin ose subjektin e Projektit që kanë ndërmarrë veprime të duhura për Bankën për të rregulluar situatën;

Banka, duke njoftuar Marrësin, mund ta anulojë financimin e Grantit në tërësi ose pjesërisht. Ky anulim do të hyjë në fuqi kur të jepet njoftimi.”

17. Seksioni 8.03 (Zgjidhja për moshyrje në fuqi), paragrafi “a”, fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me formulimin e mëposhtëm:

a) “Kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi deri në datën që është njëqind e tetëdhjetë (180) ditë kalendarike nga data e kësaj Marrëveshjeje; ose”.

18. Seksioni 9.01 (*Njoftime*) “Për bankën”, vëmendja dhe detajet e kontaktit fshihen dhe zëvendësohen me sa vijon:

Në vëmendje të:

Granti: Departamenti i Administrimit të Operacioneve

Granti i TC-së: Donald Mishaxhiu

Faks: +44 20 7338 6100

Telefon: +44 20 7338 7109 E-mail: mishaxhd@ebrd.com”

19. Programi 1 (*Përshkrimi i Projektit*), paragrafi 3, fshihen dhe zëvendësohen me sa vijon:

“3. Projekti pritet të përfundojë deri më 31 dhjetor 2022.”.

20. Skeduli 2 (*Zërat e financuar nga Granti*), fshihet dhe zëvendësohet me sa vijon:

SKEDULI 2

ZËRA QË FINANCOHEN NGA GRANTI

Tabelat e paraqitura në këtë skedul paraqesin zërat e financuar nga Granti, zërat e financuar nga Granti TC dhe shumën e financimit të Grantit dhe Grantin TC që alokohet për çdo zë të financuar nga Granti, zërat e financuar nga Granti TC dhe llogaritjen e kostos të Projektit dhe Planin e Financimit.

Pjesa A

	Zërat e financuar nga Granti Capex	Shuma e financimit të granteve të alokuara në EURO
1	Kontrata për punime për rehabilitimin e linjës Durrës–Tiranë (PTI) dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës	32,935,000

Pjesa B

	Zërat e financuar nga Granti TC	Shuma e Grantit TC alokuar në EURO
1	Shërbime të mbikëqyrjes së punimeve	1,500,000
2	Zbatimi dhe mbështetje për NJZP-në	1,000,000



Llogaritja e kostos së Projektit dhe Plani i Financimit

Kostot e Projektit dhe Plani i Financimit (EURO m)	Hua e BERZH-it	Grant i BERZH-it	Grant i BE/BERZH	Qev. e Shqipërisë	TOTALI
Punime civile (përfshirë kontigjencën)	36,87		32,935		69,8
Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit*			1,215		1,215
Mbikëqyrje e punimeve			1,5		1,5
Zbatimi dhe mbështetje për NJZP-në			1		1
Forcimi i kapaciteteve të institucionit		0,87			0,87
Blerja e tokës				1	1
TVSH				15,06	15,06
Totali	36,87	0,87	36,65	16,06	90,45

* Ky komponent i Projektit është plotësuar.

21. Pasqyra 1 (*Formulari i kërkesës për disbursim*), paragrafi 3: “[Zbatimi i garancisë me kërkesat e seksionit 2.02 (c) (*Kushtet që i paraprijnë disbursimit*), duke përdorur formulimin e atij seksioni]” fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me formulimin e mëposhtëm:

“[Një kërkesë korresponduese tërheqjeje sipas Marrëveshjes së Huas është bërë në lidhje me financimin e Huas së alokuar për të njëjtët zëra të financuar nga Granti për një shumë të paktën të barabartë me 50 (pesëdhjetë) për qind të shpenzimeve totale që do të financohen nga ky disbursim dhe tërheqje e njëhershme kolektivisht].”

22. Pasqyra e re 3 (*Formulari i deklaratës së miratimit të shërbimeve të konsulencës*) përfshihet pas pasqyrës 2 si vijon:

SKEDULI 3
FORMULARI I DEKLARATËS SË
MIRATIMIT TË SHËRBIMEVE TË
KONSULENCËS

[Të nënshkruhet nga subjekti i Projektit dhe të dërgohet me faturën/at për shërbimet nga Konsulenti.]

Numri i faturës: Marrëveshja e Grantit të TC-së
Data e faturës: nr.: **C40458/6871/28931**

Shuma e faturës: OL: **Donald Mishaxhiu**

1. Në pajtim me Kontratën e Konsulencës për [shënoni detajet] [“Shërbimet”], datë _____, të

lidhur midis **Hekurudha Shqiptare sh.a.** [subjekti i Projektit] dhe [shënoni emrin] [“Konsulenti”] dhe në pajtim me seksionin 7.02 (d) të Marrëveshjes së Grantit të datës 9 maj 2018 (të ndryshuar dhe të rishikuar herë pas here), të lidhura ndërmjet **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** (“Banka”) dhe Marrësit, subjekti i Projektit deklaron se:

i. subjekti i Projektit ka pranuar dhe është i kënaqur me shërbimet e Konsulentit, të cilat janë kontraktuar në Kontratën e Konsulencës dhe mbulohen nga faturat bashkëlidhur;

ii. subjekti i Projektit ka kontrolluar faturën/at dhe të gjitha dokumentet mbështetëse që lidhen me kryerjen e Shërbimeve kundrejt shumës së përcaktuar në listën B të Kontratës së Konsulencës dhe është i bindur që:

a) fatura/at është/janë një përfaqësim i vërtetë i shërbimeve të ofruara nga Konsulenti; dhe

b) shuma e ngarkuar në faturë (korrespondon) me shumën/at e përcaktuar/a në listën B të kontratës së konsulencës;

iii. fatura/t dhe të gjitha dokumentet mbështetëse janë përcjellë së bashku me këtë deklaratë miratimi për operacionet e financuara nga Donatori i Bankës për pagesë; dhe

iv. Subjekti i Projektit ka paguar çdo taksë të tërthortë, duke përfshirë TVSH-në për Konsulentin, në lidhje me faturat e mëparshme, dhe merr përsipër të paguajë tatimet e tërthorta,



duke përfshirë TVSH-në në lidhje me faturën bashkëlidhur, brenda 30 ditëve nga data e kësaj deklarate miratimi.

2. **Subjekti i Projektit** deklaron se me nënshkrimin e këtij dokumenti, **subjekti i Projektit** autorizon Bankën që të kryejë pagesën e rënë dakord në Kontratën e Konsulencës për Konsulentin në emër të **subjektit të Projektit**.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë deklaratë më
Datë

PËR DHE NË EMËR TË:
Hekurudha Shqiptare sh.a.

URDHËR
Nr. 687, datë 15.11.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrit të Ministrisë së Kulturës, znj. Valbona Shujaku.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Kulturës do të ushtrohen për periudhën 18.11.2019 deri më 21.11.2019.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, znj. Valbona Shujaku.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

VENDIM
Nr. 179, datë 20.11.2019

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME PAKICË)

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12 dhe 50; nenit 22, pika 2, germa “c”; nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 8, nenit 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e”; dhe nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL” sh.a., dhe relacionin me nr. 102/8 prot., datë 12.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për “Mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘ALBPETROL’ sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)”.

konstatoi se:

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën e saj nr. 9605 prot., datë 25.10.2019, protokolluar në ERE me numrin 683 prot., datë 30.10.2019, ka paraqitur në ERE aplikimin për fillimin e procedurës për pajisjen me licencë “Furnizimi i gazit natyror (shitje me pakicë)”.

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., nuk ka depozituar në ERE asnjë dokument sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Shoqëria ka depozituar në ERE vetëm kërkesën për licencim, por pa e shoqëruar atë me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm për të legjitimuar shqyrtimin e kërkesës, në kuptim të parashikimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.



- Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., të jetë kryer pagesa e aplikimit, sipas parashikimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 180, datë 20.11.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 2.11.2007, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neni 67, 85 dhe 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/10 prot., datë 12.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. është licencuar nga ERE-ja me vendimin nr. 61, datë 2.11.2007, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (parku eolik Pogradec dhe Korçë) me fuqi 150 mw, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga bordi i komisionerëve të ERE-s për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të këtij licencimi, e pas kërkesës së subjektit, ERE-ja ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik Pogradec dhe Korçë (Projekti KAPPET), si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet nr. 56, datë 25.8.2010 dhe nr. 136, datë 15.11.2013.

- ERE-ja, me vendimin nr. 6, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE-ja, shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, ‘Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike’”, ka vendosur: Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE-ja në pikën 1 dhe 4, të vendimit nr. 61, datë 25.11.2007 “Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale (Projekti KAPPET)”, të ndryshuar, shoqërisë “Hera” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, deri në datën 15.11.2019.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresat nr. 556 prot., datë 16.9.2019 dhe nr. 556/1 prot., datë 16.9.2019, duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve, me qëllim që të sigurojë kohën e mjaftueshme për zhvillimin e këtij projekti. Shoqëria HERA sh.p.k. kërkon nga ERE-ja marrjen në shqyrtim të kërkesës për shtyrjen e afatit të licencës për një periudhë kohe të paktën prej 48 muajsh, ose për çdo periudhë tjetër që ERE-ja do të vlerësojë për të mundësuar zhvillimin e projektit.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, bashkëlidhur kërkesës së saj, raportin e studimit të fizibilitetit dhe raportet e studimit të erës në zonën e projektit të kryera nga studio të specializuara.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të



kushteve me 48 muaj, me qëllim që të sigurojë kohën e mjaftueshme për zhvillimin e këtij projekti.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. ka përcjellë studimin e fizibilitetit për projektin KAPPET, të kryer nga Encon Consulting Albania.

- Shoqëria nuk ka depozituar marrëveshjen nr. 857/1, datë 22.7.20107, të lidhur midis shoqërisë HERA sh.p.k. dhe OST sh.a. për pikën e lidhjes me sistemin.

- Rezulton se shoqëria “HERA” sh.p.k., ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga argumentet, shpjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga aplikuesi, me qëllim shtyrjen e afateve të vendimit të bordit të ERE, sipërcituar, nuk rezulton të jenë dhënë prova të mjaftueshme dokumentare të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi për miratimin e kërkesës për shtyrje.

- Neni 67, i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

- Kodi i procedurave Administrative në nenin 85, pika 3 të tij parashikon se: Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

- Në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, siç parashikuar në nenin 22, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE-ja mund të ushtrojë aktivitetin e saj monitorues me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm nga i licencuari, për të krijuar bindjen e plotë e të arsyeshme se kërkesa e paraqitur plotëson kushtet ligjorë, administrativ dhe teknik për t’u pranuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të bordit të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (parku eolik Pogradec dhe Korçë)” deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit “HERA” sh.p.k. për të evidentuar, dokumentuar e shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, “Për licencimin e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k.”, të ndryshuar, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Aplikuesi, shoqëria “HERA” sh.p.k., është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm, me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e tij, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 181, datë 20.11.2019****MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALB WIND ENERGY” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 13, DATË 28.1.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 67, 85 dhe 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/11 prot., datë 12.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE-ja me vendimin nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU, me fuqi 140 mw, dhe TERPAN, me fuqi 85 mw, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip, të miratuar nga bordi i komisionerëve, për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE-ja ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik Sarandë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet nr. 68, datë 13.9.2010 dhe nr. 139, datë 15.11.2013.

- ERE-ja, me vendimin nr. 6, datë 10.01.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE-ja, shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, ‘Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike’”, ka vendosur: Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE-ja në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, “Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e

energjisë elektrike nga këto centrale, shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k. për projektet Visu dhe Terpan”, të ndryshuar, mbajtëse e licencës nr. 53, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, deri në datën 15.11.2019.

- Shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 701 prot., i ERE-s, datë 5.11.2019, duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve, me qëllim që të sigurojë kohën e mjaftueshme për zhvillimin e këtyre projekteve. Shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. kërkon nga ERE-ja marrjen në shqyrtim të kërkesës për shtyrjen e afatit të licencës për një periudhë kohe të paktën prej 48 muajsh, ose për çdo periudhë tjetër që ERE-ja do të vlerësojë, për të mundësuar zhvillimin e projektit.

- Aplikuesi bën me dije se për shkak të kompleksitetit të problematikave që i licencuari ka hasur, nuk ka mundur të plotësojë në kohë kushtet e vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k”, të ndryshuar.

- Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE, bashkëlidhur kërkesës së saj, raportin e studimit të fizibilitetit për të cilin deklaroi se e ka kryer.

- Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE pikën e lidhjes me rrjetin energjetik.

- Rezulton se shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k., është debitore ndaj ERE-s, në masën 40 000 lekë, për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga argumentet, shpjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga aplikuesi, me qëllim shtyrjen e afateve, nuk rezulton të jenë dhënë prova të mjaftueshme dokumentare të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi për miratimin e kërkesës për shtyrje.

- Neni 67 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktoje një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

- Kodi i procedurave Administrative në nenin 85, pika 3 e tij parashikon se: Në ato raste kur



informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

- Në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, siç parashikuar në nenin 22, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE-ja mund të ushtrojë aktivitetin e saj monitorues me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm nga i licencuari, për të krijuar bindjen e plotë e të arsyeshme se kërkesa e paraqitur plotëson kushtet ligjore, administrative dhe teknike për t’u pranuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU dhe projekti TERPAN, deri në përfundimin e monitorimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit “Alb Wind Energy” sh.p.k. për të evidentuar, dokumentuar e shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k.”, të ndryshuar, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Aplikuesi, shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k., është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm, me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si

dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 182, datë 20.11.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 89, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 67, 85 dhe 114, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/12 prot., datë 13.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes lidhur me kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE-ja me vendimin nr. 89, datë 6.8.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centralet eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme) me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga bordi i komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE-ja ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve eolike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet nr. 19, datë 8.3.2010, nr. 92, datë 6.9.2011 dhe nr. 138, datë 15.11.2013.



- ERE-ja, me vendimin nr. 1, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE-ja shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 63, seria NPM08P, ‘Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok-motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë)”, ka vendosur: Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura në pikën 1, të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar, shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., mbajtëse e licencës me nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme”, deri në datën 15.11.2019.

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 726 prot., i ERE-s, datë 11.11.2019, duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit deri në një moment të dytë kur të jenë kushtet optimale, për arsye se i nevojitet të sigurojë kohën e mjaftueshme për zhvillimin e këtij projekti, i cili do t'i nënshtrohet një vlerësimi ekskluzivisht për qëllime të balancimit të rrjetit për prodhimet nga era, në konsideratë të përshkrimeve të dhëna në autorizim nga ana e OST sh.a. dhe do vlerësohet nëse do të rezultojë i përballueshëm nga pikëpamja ekonomiko-financiare.

- Për shkak të kompleksit të problematikave që i licencuari ka hasur, nuk ka mundur të plotësojë në kohë kushtet e vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k.”, të ndryshuar.

- Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE oponencën tekniko-ekonomike, nga ekspertë të licencuar.

- Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin.

- Nga argumentet, shpjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga aplikuesi, me qëllim shtyrjen e afateve të vendimit të bordit të ERE-s sipërcituar, nuk rezulton të jenë dhënë prova të mjaftueshme dokumentare të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi për miratimin e kërkesës për shtyrje.

- Neni 67 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se

mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktojnë një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

- Kodi i Procedurave Administrative në nenin 85, pika 3 të tij parashikon se: Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

- Në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, siç parashikuar në nenin 22, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE-ja mund të ushtrojë aktivitetin e saj monitorues me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm nga i licencuari, për të krijuar bindjen e plotë e të arsyeshme se kërkesa e paraqitur, plotëson kushtet ligjore, administrative dhe teknike për t'u pranuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të bordit të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centralet eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme)”, deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit “Albanian Green Energy” sh.p.k. për të evidentuar, dokumentuar e shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 89, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k.”, të ndryshuar, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.



3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Aplikuesi, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare,

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 183, datë 20.11.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 67, 85 dhe 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative”, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 110/3 prot., datë 13.11.2019 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit të ERE-s nr. 3, datë 10.1.2018, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 90, datë 6.8.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe

shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, Lezhë, Shëngjin, me kusht zbatimin e saparashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike, si dhe kushteve të parashikuara në pikën 1, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f” të këtij vendimi.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe të shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë “BPGE 1” dhe “BPGE 2” në Shëngjin, Lezhë, si dhe prodhimit të energjisë elektrike prej tyre, me vendimet nr. 20, datë 8.3.2010, nr. 93, datë 6.9.2011, dhe nr. 137, datë 15.11.2013.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 3, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 64, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike”, ka vendosur: Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura në pikën 1 germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f” të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar, shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 64, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike”, deri në datën 15.11.2019.

- Nga shoqëria, me shkresën nr. 373 prot., datë 30.6.2019, është kërkuar zhvillimi i një seance dëgjimore dhe në vijim të kësaj kërkesë është diskutuar në ERE në datën 12.6.2019, në lidhje me ecurinë e projektit të parkut eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2”.

- Shoqëria paraqiti në seancë edhe hartat e zonës ku do të shtrihet projekti dhe bëri me dije se ka hasur vështirësi në miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin, si dhe pajisjen me leje mjedisore.

- Me shkresën e depozituar në ERE me nr. 419 prot., datë 24.6.2019, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka përditësuar informacionin në lidhje me ecurinë e parkut eolik, si më poshtë:

- është bërë përditësimi i *lay-out*-it të projektit, sipas hartës së shkallës 1:20.000, të cilën e ka përcjellë në ERE, duke marrë në konsideratë teknologjinë dhe veprat infrastrukturore të parashikuara në territor;



- është rikonfirmuar kapacitetit total prej 234 mw;

- është reduktuar numri i turbinave nga 79 në 39, sipas aneksit A të depozituar në ERE. Secila turbinë do të ketë një kapacitet prej 6 mw;

- është depozituar në OST kërkesa e re për lidhjen me rrjetin elektrik dhe në ERE shoqëria ka depozituar skemën unifilare dhe planimetrinë e përgjithshme të projektit.

- Së fundmi, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 419/1 prot., datë 8.11.2019, me anë të së cilës informon si më poshtë:

- Ka përfunduar projektimi përfundimtar i rrugëve hyrëse në kodra, duke zgjidhur realizimin e rrugëve të reja hyrëse, të pavarura, me qëllim minimizimin e impaktit mbi ndërtesat ekzistuese dhe mbi pronat private;

- Janë duke përfunduar punimet për instalimin e anemometrave të rinj, të nevojshëm për të përfunduar certifikimin bankar të studimit të erës, për të cilët ka përcjellë në ERE dokumente shpjegues bashkëlidhur shkresës.

- Shoqëria deklaron se, në datën 24 tetor 2019, me shkresën nr. 4169/3 prot., u arrit të merret nga ana e OST-së, “Autorizimi paraprak mbi pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit të parqeve me erë”, të cilin e ka përcjellë edhe në ERE.

- Shoqëria deklaron se ka bërë zyrtarisht aplikimin në AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimit) për të fituar statusin e projektit strategjik dhe në vazhdimësi është bërë edhe depozitimi zyrtar në datën 5 nëntor, i hartave kadastrale të të gjitha tokave në interes të projektit, me synim kontrollin/verifikimin e pronës.

- Është përditësuar grafiku i punimeve, të cilin e ka përcjellë edhe në ERE, në formë narrative dhe tabelare. Në këtë grafik punimesh ka të dhëna për zonat e ndërhyrjes, qarkullimin, sheshet e montimit, themelet, montimi i aerogjeneratorëve dhe veprat elektrike. Në pjesën tabelare pasqyrohen periudhat, sipas aktiviteteve që kanë të bëjnë me projektin përfundimtar dhe konkluzionet, aprovimin, projektin ekzekutiv, aprovimi, realizimi, kolaudimi, vënia në punë dhe fillimi i punës. Të gjitha këto parashikohen të kryhen brenda intervalit shtator 2019–dhjetor 2021.

- Është kryer një oponencë mbi studimin e fizibilitetit për parkun eolik Lezhë, për të cilin është konkluduar, se studimi i fizibilitetit i parkut eolik, që parashikon instalimin e 39 turbinave me fuqi të instaluar 6 mw/njësi të centraleve: BPGE1, me një fuqi të instaluar prej 114 mw dhe 19 njësi aerogjeneratorësh; BPGE2, me një fuqi të instaluar prej 120 mw dhe 20 njësi aerogjeneratorësh, do të ketë impakt pozitiv si nga ana socioekonomike, ashtu edhe nga ana mjedisore.

- Shoqëria bën me dije se ka përfunduar studimi i plotë i fizibilitetit, por nuk rezulton të jetë depozituar një kopje e tij në ERE.

- Është duke u përgatitur kërkesa për rinovimin e lejeve mjedisore, pasi ka përfunduar vlerësimi i ndikimit në mjedis.

- Shoqëria bën me dije, se, pas marrjes së Statusit të projektit strategjik dhe marrjes së lejes mjedisore, do të procedohet me lejet e nevojshme të ndërtimit dhe me nënshkrimin e kontratës përfundimtare me OST-në për lidhjen me rrjetin.

- Rezulton se shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., i ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga argumentet, shpjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga aplikuesi, me qëllim shtyrjen e afateve të vendimit të bordit të ERE të sipërcituar, nuk rezulton të jenë dhënë prova të mjaftueshme dokumentare, të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi për miratimin e kërkesës për shtyrje.

- Neni 67 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

“1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.”

- Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 85, pika 3 të tij, parashikon se: “Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura



pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

- Në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, siç parashikohet në nenin 22, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE mund të ushtrojë aktivitetin e saj monitorues, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm nga i licencuar, për të krijuar bindjen e plotë e të arsyeshme se kërkesa e paraqitur plotëson kushtet ligjore, administrative dhe teknike për t’u pranuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të bordit të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. në ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centralët eolike “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, Lezhë Shëngjin, deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Të ushtrojë monitorim pranë subjektit “Biopower Green Energy” sh.p.k. për të evidentuar, dokumentuar e shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe të afateve të parashikuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 90, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., të ndryshuar, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Aplikuesi, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., është përgjegjës për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm, me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.

5. Drejtoria e Licencimit të Autorizimeve dhe të Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e tij, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 184, datë 20.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR BURIMET DYTËSORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 70, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike në lidhje me draftin e “Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE, në bashkëpunim me USAID-in përgatiti draftrregulloren mbi kushtet teknike për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim parandalimin e çrregullimeve në rrjet.

- ERE, me shkresën nr. 710 prot., datë 8.11.2018, e dërgoi këtë draft pranë shoqërisë OSHEE sh.a. për opinione dhe komente.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 572/2 prot., datë 19.12.2018, në vijim edhe të shkresave nr. 1689 1/prot., datë 28.9.2018, “Mbi implementimin e rregullores për kriteret standarde të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017 të Bordit të ERE-s; shkresës nr. 25763 prot., datë 24.11.2017, “Mbi lidhjen në rrjetin shpërndarës të impianteve të reja gjeneruese nga energjia e rinovueshme”; si dhe studimin e kryer “Impakti i lidhjes së FV-së në rrjetin shpërndarës”; shkresës nr. 16894/1 prot.,



datë 27.11.2018, “Kthim përgjigje shkresës nr. 573 prot., datë 4.9.2018, ‘Mbi problematikat teknologjike dhe financiare për energjinë elektrike të tepërt të prodhuar nga impiantet fotovoltaike në ndërtesa’”, ku parashtrohen problematikat e rrjetit të shpërndarjes dhe të paaftësisë e tij për të përmbushur detyrimet sipas Kodit të Shpërndarjes - OSHEE sh.a. rithekson se me gjithë masat e marra dhe investimet e kryera në rrjetin e shpërndarjes vazhdon të ketë probleme, të cilat aktualisht e bëjnë të pamundur instalimin e burimeve dytësore të furnizimit me energji elektrike për klientët që e kërkojnë këtë shërbim, për arsyet e mëposhtme:

- Rrjeti i shpërndarjes i OSHEE sh.a. është në operim dhe monitorim manual dhe jo *online* (mungesa e SCADA-s teknologjive kontroll-monitoruese), sikurse janë në të gjithë operatorët e vendeve të tjera anëtare të Komunitetit Evropian.

- Rrjeti TM 35 kV, 10 kV dhe 6 kV ka një periudhë të gjatë shfrytëzimi dhe, për rrjedhojë, është i amortizuar në gjatësi, seksione dhe materiale të ndryshme gjatë gjithë gjatësisë, duke kapërcyer disa herë normat, rregullat dhe standardet teknike.

- Rrjeti shpërndarës 6–10 kV vazhdon të amortizohet dhe, si i tillë, jo vetëm që nuk përballon ndryshimet e theksuara klimaterike, por cilësia e furnizimit është e dobët.

- Pamundësia e kryerjes së bilancit të energjisë elektrike në kohë reale.

- Nënstationet 110/35/TM kV dhe 35/TM janë me shfrytëzim 38–40-vjeçar, me pajisje me izolacion të dobësuar dhe të amortizuar.

- Sistemi i rrjetit 35 kV, 10 kV dhe 6 kV nuk shoqërohet me stakim nga lidhjet e shkurtra me tokën, duke sjellë vonesa në ndërprerjet e paplanifikuara.

- Në OSHEE sh.a. 45% e kabinave TM/TU janë kabina private që nuk menaxhohen dhe mirëmbahen nga OSHEE sh.a., të cilat janë burim avarish dhe vonesash për kthimin në gatishmërinë e rrjetit të shpërndarjes.

- Në rrjetin shpërndarës të OSHEE sh.a. janë lidhur 117 njësi të vogla gjeneruese të cilat performojnë në nivele të ulëta në zonat ku injektojnë energjinë, duke u shoqëruar me një përkeqësim të performancës gati 10 herë në raport me zonat e tjera ku nuk ka njësi gjeneruese.

- Terrenet e vështira në zonat e thella malore shoqërohen me mungesë ndërlidhjeje me

personelin operativ të nënstationeve dhe vonesë të kryerjes së veprimeve operative.

- Në zonat e thella rurale ka mungesë në infrastrukturë, duke krijuar vështirësi për personelin remontues në kushte normale dhe në gjendje avarie.

- Referuar problemeve të mësipërme, OSHEE sh.a. arsyeton dhe konkludon për klientët që e kërkojnë këtë shërbim si më poshtë vijon:

- Ajo është e papërgatitur dhe e paaftë teknikisht për të plotësuar kushtet teknike për instalimin e burimeve të dyta të furnizimit me energji elektrike për klientët që e kërkojnë këtë shërbim, për t'u lidhur në rrjetin e shpërndarjes së saj.

- Ajo do të pranojë për të certifikuar vetëm burimet e dyta të cilat do të jenë për përdorim të brendshëm, për vetë konsumatorin (autokonsum) dhe jo me të drejtë lidhjeje direkte apo injektimi të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes. Për këtë rast do të respektohet një protokoll teknik të shprehur si detyrim për plotësim nga klienti që kërkon këtë shërbim, sipas kriterëve të shprehura në aktmarrëveshjen tip të dy palëve të miratuar nga ERE.

- Kjo e drejtë do të jetë vetëm për subjektet e mëposhtme:

- a) objektet e rëndësisë së veçantë, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes;

- b) objekte që ushtrojnë aktivitete për shërbime të mëdha publike me fuqinë e kërkuar mbi 100 kw;

- c) objekte industriale, për të cilat ndërprerja e energjisë shkakton dëme ekonomike për fuqi të kërkuar mbi 100 kw.

- Në vijim të shkresës nr. 572/2 prot., datë 19.12.2018, ERE i përgjigjet OSHEE sh.a. me shkresën nr. 166 prot., datë 18.2.2019, ku ndër të tjera i thekson, se për sa i përket gjendjes së amortizuar të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe mungesës së sistemit SCADA për integrimin e këtyre sistemeve, ERE ka shqyrtuar dhe ka miratuar planet e investimeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si rrjedhojë nëse OSHEE sh.a. ka hasur problematika tekniko-financiare në lidhjen e këtyre impianteve, këto duhet të parashikohen në planet e investimeve të përcjella për shqyrtim dhe miratim sipas procedurave pranë ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 412/1, datë 3.7.2019, ka kërkuar nga OSHEE sh.a. depozitim të



draftrrregullores mbi kushtet teknike për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim parandalimin e çrregullimeve në rrjet.

- OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 412/2 prot., datë 8.7.2019, ka paraqitur në ERE draftrrregulloren teknike për burimet dytësore, me dedikim rezervë dhe që nuk punojnë në paralel me rrjetin e shpërndarjes të OSHEE sh.a.

- Rregullorja ka nevojë për plotësim të saj nga ana e OSHEE sh.a., për pikat në vijim:

- të konsultohen të gjitha afatet e parashikuara në rregullore që të jenë në përputhje edhe me rregullat e brendshme të kompanisë lidhur me sigurimin teknik;

- të plotësohet me modelin e certifikatës së pajtueshmërisë me sistemin;

- të sqarohen arsyet përse kërkohet kategorizimi i lidhjes në rrjet të burimit dytësor vetëm për objekte të rëndësishë së veçantë dhe me fuqi të madhe;

- të sqarohet se sa është afati potencial i implementimit të rregullores nga ana e tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet OSSH sh.a. që të argumentojë me relacion shpjegues afatet e implementimit të pritshëm të këtij akti, jo më vonë se 30 ditë nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 185, datë 20.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KRITEREVE PËR TË VENDOSUR KUFIZIME, SIPAS KËRKESAVE PËR LIDHJEN E MODULEVE TË GJENERIMIT”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; parashikimeve të vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë; neneve 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Rregullores së Komisionit (KE) 2016/631, datë 14 prill 2016; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë e ERE me nr. 102/9 prot., datë 12.11.2019, “Për fillimin e procedurës për miratimin e ‘Kriterëve për të vendosur kufizime sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit””,

konstatoi se:

- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006;

- Transpozimi, si dhe zbatim i kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit që dalin nga institucionet Evropiane është një nga aktivitetet kryesore të punës së institucioneve përkatëse në Shqipëri.

- Autoriteti rregullator (ERE) duhet të specifikojë kriteret për vendosjen e derogimeve (kufizimeve), sipas përcaktimeve të neneve 62 dhe 63 të rregullores së publikuar nga ENTSO-E, pasi të konsultohet me operatorët përkatës të sistemit dhe zotëruesit e objektit gjenerues të energjisë elektrike si dhe pjestarë të tjerë të tregut të energjisë elektrike, të cilët vlerëson se mund të preken nga këto rregulla.

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtar me të drejta të plota e ENTSO-E.

- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, kjo rregullore miratohet nga ERE, si detyrë që buron nga Rregullorja e Komisionit Evropian (KE) 2016/631, datë 14 prill 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën miratimin e “Kritereve për të vendosur kufizime, sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESE

Shtetasja Silvana Begaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Edmond Kananaj, lindur në datën 19.2.1977, në fshatin Armen, Vlorë.

KËRKUES
Silvana Begaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë